



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 25/21 regjistër (JR)
Datë 11.05.2021

Nr. 17 i vendimit
Datë 06.07.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më 06.07.2021, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Gramoz Levanaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI I ANKIMIT: Kundërshtimi i pjesshëm i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 365, datë 14.04.2021

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 6 e vijim; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, nenet 136, 136/1, 136/3, 139 e vijim; ligji ndryshues i Kushtetutës nr. 76/2016, datë 22.7.2016, nenet 136, 113/5, 139, 139/2, 179/4, 179/b, 179/b/2, 179/b/5, nenet F, G të Aneksit të Kushtetutës; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 5, 6, 13, 14, 42, 45, 47, 78, 87, 50, 84 e vijim; ligji nr. 49/2012, neni 46 e vijim; ligji nr. 96/2016, nenet 1, 3, 5, 7, 11, 12, 22, 36, 61, 62, 64, 65 e vijim; ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; vendimi nr. 78/2018 i Gjykatës Kushtetuese.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

(në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 365, datë 14.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me pikën e dytë të dispozitivit që përcakton humbjen e së drejtës për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, duke kërkuar mosaplikimin e këtij kufizimi, dëgjoi gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Gramoz Levanaj, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ishte gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, për rrjedhojë, në zbatim të kësaj dispozite, dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, duke u shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur më datë 15.01.2019.
2. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit Gramoz Levanaj, ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, përkatësisht kontrollin e pasurisë, figurës dhe të aftësisë profesionale. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se Komisioni, më datë 29.01.2019, ka filluar komunikimin me subjektin e rivlerësimit duke e njoftuar atë për përbërjen e trupës gjyqësore. Trupi gjyqësor i Komisionit, me vendimin e datës 15.09.2020, vendosi të mbyllë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Gramoz Levanaj, vetëm për kriterin e pasurisë. Në datën 19.09.2020, subjekti u njoftua në rrugë elektronike për rezultatet e hetimit dhe të drejtën për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes.
3. Nga aktet, rezulton se subjekti i ka kërkuar Komisionit zgjatjen e afatit për të dhënë përgjigje për pyetjet e bëra lidhur me kontrollin e pasurisë, si dhe rihapjen e hetimit për dy kriteret e tjera, të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale. Në datën 5.10.2020, Komisioni, në rrugë elektronike, ka njoftuar subjektin i rivlerësimit për shtyrjen e afatit të kthimit të përgjigjeve më datë 20.10.2020, duke shprehur gjithashtu se rihapjen e hetimit për dy kriteret e tjera, Komisioni e çmoi të panevojshme në këtë fazë të hetimit administrativ.
4. Komisioni, me vendimin e datës 17.11.2020, vendosi rihapjen e hetimit administrativ vetëm për kriterin e pasurisë dhe në datën 20.11.2020, njoftoi subjektin e rivlerësimit me rrugë elektronike. Në datën 12.1.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike nga Komisioni për rezultatet shtesë të hetimit për kriterin e pasurisë, ku iu dha kohë për kthimin e përgjigjeve dhe depozitimin e provave deri më 18.01.2021. Në datën 18.01.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike duke dërguar një pjesë të shpjegimeve për rezultatet shtesë të hetimit, dhe shtoi se pjesën tjetër të papësimave do e dërgojë në vijim, sapo ta ketë gati.
5. Komisioni, me vendimin e datës 19.01.2021, vendosi ta ftojë subjektin në seancën dëgjimore, e cila do të mbahej në datën 29.01.2021, ora 10:00. Subjekti i rivlerësimit, në datën 21.01.2021, u njoftua në rrugë elektronike për seancën dëgjimore.
6. Në datën 27.01.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se është në pamundësi për t’u paraqitur në seancën dëgjimore të datës 29.01.2021 për shkaqe shëndetësore dhe kërkon shtyrjen e saj, duke bashkëngjitur edhe raportin mjekësor për paafësi të përkohshme në punë deri në datën 10.02.2021.
7. Në datën 09.02.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike, duke i bërë me dije se kërkon pezullimin e seancës dëgjimore të datës 11.02.2021, ora 10:30, deri në shqyrtimin e

kërkesës nga KLGj-ja, pasi ai ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) “heqjen dorë në mënyrë të parevokueshme nga statusi i gjyqtarit” dhe “heqjen dorë në mënyrë të parevokueshme nga detyra e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë”. Subjekti i ka bashkëngjitur këtë njoftim kërkesën¹ për dorëheqje në mënyrë të parevokueshme nga statusi i magjistratit dhe nga detyra e gjyqtarit të Apelit.

8. Në datën 10.02.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike që Komisioni u njoh me kërkesën e subjektit për pezullimin e seancës dëgjimore dhe i bën me dije se seanca dëgjimore do të zhvillohet pas vendimmarrjes nga KLGj-ja. Komisioni i bën me dije gjithashtu subjektit se ka të drejtën të shprehet në lidhje me përfundimin e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke mbajtur në konsideratë pikat 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni i kërkon subjektit, nëse ai dëshiron, të shfrytëzojë të drejtën për të marrë pjesë në seancën dëgjimore që do të njoftohet në të ardhmen ose nëse dëshiron të heqë dorë nga kjo e drejtë.
9. Në datën 13.02.2021, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin në rrugë elektronike se ai nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën dëgjimore.
10. Me shkresën “Njoftim vendimi” të datës 17.02.2021, protokolluar nga Komisioni në datën 17.02.2021, KLGj-ja njoftoi miratimin e kërkesës për dorëheqje të subjektit Gramoz Levanaj, duke deklaruar mbarimin e statusit të tij si magjistrat pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe vuri në dispozicion të Komisionit vendimin nr. 61, datë 16.02.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

11. Vendimi nr. 365, datë 14.04.2021, është marrë nga Komisioni pasi është administruar vendimi nr. 61, datë 16.02.2021, i KLGj-së “Për mbarimin e statusit të magjistratit, z. Gramoz Levanaj, gjyqtarit të gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status”. Ndaj këtij vendimi të KLGj-së², ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim.
12. Pas konfirmimit të Gjykatës Administrative të Apelit për mosankimin e vendimit të KLGj-së, Komisioni, me vendimin nr. 365, datë 14.04.2021 – bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 61, datë 16.02.2021, i cili ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Gramoz Levanaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status, dhe bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës – ka vendosur të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Gramoz Levanaj dhe humbjen e së drejtës së tij për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

III. Shkaqet e ankimit

13. Subjekti i rivlerësimit Gramoz Levanaj ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 365, datë 14.04.2021, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon.

¹ Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e seancës dëgjimore është protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 9.2.2021. Gjithashtu, subjekti ka bashkëngjitur edhe kërkesën për dorëheqje të parevokueshme nga statusi i gjyqtarit, si dhe nga funksioni i gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, me shënimin “dorëzuar në KLGj, në datën 9.02.2021”.

² Referuar përgjigjes së përcjellë KLGj-së nga Gjykata Administrative e Apelit me nr. {***} prot., datë 08.04.2021, rezulton se pranë kësaj gjykate nuk është paraqitur ankim nga subjekti i rivlerësimit kundër vendimit të KLGj-së nr. 61, datë 16.02.2021.

13.1. Sanksioni i vendosur në pikën 2 të vendimit të Komisionit, e cila deklaron humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar për një periudhë 15-vjeçare si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, vjen në kundërshtim me çdo element përbërës të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (si paanësia e pavarësia e trupit gjykues).

13.2. Ndalimi i subjektit për të qenë për 15 vite pjesë e sistemit të drejtësisë, vjen në kundërshtim me natyrën administrative të objektit të shqyrtimit, si dhe të trupës gjyquese që e ka shqyrtuar atë, e cila ka shfaqur një karakter më radikal edhe se parashikimet penale me një ndalim të tillë.

13.3. Ndalimi i subjektit të rivlerësimit për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për 15 vite, vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit që duhet të ruhet midis masës së marrë dhe situatës ligjore që e ka diktuar atë.

13.4. Pika e 2-të e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, vjen në kundërshtim me garancitë juridike mbi të drejtën për privatësi që ofron neni 8 i KEDNj-së.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit Ë, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Gramoz Levanaj dhe për të cilin subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Lidhur me çështjen objekt gjykimi, e cila i përket shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 365, datë 14.04.2021, Kolegji vlerësoi se nuk gjendej para asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, pasi së pari, subjekti me ankimin e tij nuk ka paraqitur asnjë provë të re, sipas pikës “a” të kësaj dispozite; dhe së dyti, nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni, rezultoi se prej këtij të fundit, më datë 20.02.2021, nëpërmjet komunikimit në adresën e tij elektronike, subjekti është

njoftuar se, bazuar në kërkesën e tij, seanca dëgjimore do të zhvillohet pas vendimmarrjes se KLGj-së. Komisioni në këtë komunikim i ka bërë të ditur subjektit se në seancën dëgjimore ka të drejtën të shprehet në lidhje me përfundimin e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke mbajtur në konsideratë pikat 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në përgjigje të këtij njoftimi, subjekti, më datë 13.02.2021, ka kthyer përgjigje në rrugë elektronike se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën dëgjimore.

Referuar sa më sipër, Kolegji konstaton se përfundimi i procesit të rivlerësimit në Komision për subjektin Gramoz Levanaj, pa një seancë dëgjimore, nuk është rrjedhojë e ndonjë shkeljeje procedurale, në kuptim të nenit 51, germa “b” e ligjit nr. 49/2019, por rezultat i vullnetit të shprehur të subjektit të rivlerësimit, i cili në mënyrë të qartë ka refuzuar, duke hequr dorë me vullnet të lirë dhe pa ekuivok nga e drejta për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore për procesin e tij të rivlerësimit. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që ishin aktet e fashikullit të administruara nga Komisioni përgjatë fazës së procesit administrativ që lidhet me rivlerësimin kalimtar të këtij subjekti, dhe vendosi të gjykojë këtë çështje në dhomë këshillimi, konform rregullave të përcaktuara në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 dhe në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

17. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se sanksioni i vendosur në pikën 2 të vendimit të Komisionit, i cili deklarohet humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, është marrë në kundërshtim me çdo element përbërës të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (si paanësia e pavarësia e trupit gjykues), Kolegji analizon sa vijon.

17.1. Subjekti, pretendimet për cenim të procesit të rregullt ligjor gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioni, konstatohet se nuk i lidh me pretendime për shkelje të së drejtës për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur, por me pretendime që, sipas subjektit, lidhen me (i) cilësinë e përbërjes dhe legjitimitetin e trupit gjykues duke pretenduar se asnjë anëtar/komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk është gjyqtar, fakt i cili sipas subjektit hedh dyshime mbi paanshmërinë e këtij organi dhe vjen në kundërshtim me qëndrimet e gjykatës lidhur me përbërjen e organeve disiplinore në fushën gjyqësore; (ii) pavarësinë e organit vendimmarrës nga politika, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendon se për shkak të mënyrës së emërimit të anëtarëve të Komisionit, ajo është e ekspozuar ndaj presionit/ndikimit politik; (iii) paanësinë e vendimmarrjes së Komisionit, e cila vihet në dyshim pasi ai është organi që ka kryer njëkohësisht hetimin administrativ dhe ka marrë vendimin për procesin e tij të rivlerësimit.

17.2. Kolegji, në analizë të pretendimeve në drejtim të elementeve të procesit të rregullt ligjor që kanë të bëjnë me përbërjen, kompetencat dhe paanësinë e trupës gjykuese të Komisionit, konstaton se subjekti për këto pretendime nuk parashtron elemente apo të dhëna që tregojnë në mënyrë të qartë rastin apo situatën konkrete në të cilën, përgjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioni, ai ka vërejtur anësinë e trupës gjykuese në drejtim të ushtrimit të të drejtave themelore, si ajo për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar. Në këtë kuptim, nga aktet e administruara në fashikull dhe nga hapat proceduralë të ndjekur nga Komisioni, siç është pasqyruar edhe në paragrafët 5-10 të këtij vendimi, rezulton se janë pranuar kërkesat e subjektit për kohë shtesë për kthimet e përgjigjeve dhe për shtyje të seancës gjyqësore, duke i mundur atij realizimin e të drejtave brenda procesit të rivlerësimit. Nisur nga përmbajtja e ankimit, Kolegji gjithashtu konstaton se këto pretendime janë të njëjta me ato që janë trajtuar së pari nga Komisioni i Venecias në fazën e diskutimeve të ndryshimeve kushtetuese e ligjore për reformën në drejtësi, më pas janë shqyrtuar në nivel kushtetues nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 2/2018. Kolegji sjell në vëmendje gjithashtu se këto elemente të paanësisë së trupit

gjykues të Komisionit, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën³ e vetë Kolegjit e së fundmi janë trajtuar edhe në vendimin e GjEDNj-së, datë 09.02.2021, Xh. kundër Shqipërisë⁴.

17.3. Kolegji, ashtu si edhe GjEDNj-ja, në rastin Xh. kundër Shqipërisë, thekson se Komisioni është një organ i krijuar nga dispozitat kushtetuese, neni 179/b i saj, funksionet e të cilit janë detajuar në ligjin e posaçëm nr. 84/2016. Ky organ nisur nga mënyra e krijimit, e zgjedhjes dhe e kontrollit të anëtarëve të tij përmbush të gjitha kërkesat e kërkuara nga neni 6/1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

17.4. Në këto kushte, kur ankimi nuk ka të evidentuar asnjë ngjarje apo veprim konkret të kryer nga Komisioni, që ta ketë bërë subjektin të besojë e dyshojë për paanësinë e trupës gjyquese të Komisionit, si edhe duke pasur në konsideratë faktin se vendimmarrja për procesin e rivlerësimit të subjektit nuk është bazuar në gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit, por është pasojë e drejtpërdrejtë e dorëheqjes nga funksioni si gjyqtar i vetë subjektit të rivlerësimit dhe vendimit të KLGj-së për deklarimin e mbarimit të statusit të gjyqtarit, Kolegji çmon se ky shkak ankimi mbetet i pabazuar në aktet e administruara dhe në ligj.

18. Lidhur me shkakun tjetër të ankimit, me anë të të cilit subjekti pretendon se ndalimi për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për 15 vite vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit që duhet të ruhet midis masës së marrë dhe situatës ligjore që e ka diktuar atë, Kolegji analizon sa vijon.

18.1. Në ankim, subjekti, për këtë shkak, pretendon se ndalimi i tij për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për 15 vite, është një sanksion i një ekstremiteti të tillë sa zhvishet nga natyra administrative dhe kanalizohet në fushën penale, i ngjashëm me nenin 35 të Kodit Penal, i cili parashikon heqjen e së drejtës për punuar si punonjës shteti ose në shërbim publik për një kohë deri në 5 vite. Sipas subjektit, sanksioni i vendosur nga Komisioni, i cili është organ administrativ, tejkalon disa herë edhe dënimet penale, edhe në konsideratë të faktit se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi rrjedh/vjen nga ushtrimi i së drejtës legjitime dhe njerëzore të dhënies së dorëheqjes.

18.2. Nga analizimi i ankimit, Kolegji konstaton se mbetet i pakuptimtë paralelizmi që bën subjekti mes sanksionit të vendosur në pikën 2 të vendimit të Komisionit me sanksionet penale që kanë të bëjnë me dënimet plotësuese, kur i gjithë procesi i rivlerësimit është kryer nga Komisioni, në zbatim

³ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 32/2020 (JR), datë 23.11.2020; nr. 38/2020 (JR), datë 17.12.2020; nr. 42/2020 (JR), datë 28.12.2020.

⁴ Shih: <http://www.avokaturashetit.gov.al/njoftim-vendim-i-gjykates-evropiane-per-te-drejtat-e-njeriut-xhoxhaj-k-shqiperise-kerkesa-nr-1522719>. Në këtë vendim, GjEDNj-ja arsyeton se:

284 Krijimi dhe funksionimi i KPK-së dhe KPA-së janë parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, plotësuar më tej nga nenet C dhe F të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të miratuar nga Parlamenti. Sipas mendimit të Gjykatës, ato ofrojnë një bazë ligjore mjaft të qartë për krijimin e organeve të rivlerësimit, përgjegjëse për kryerjen e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (shih paragrafët 103, 106, 112, dhe 122-128 më lart). Fakti se organet e rivlerësimit u krijuan vetëm me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, u parashtrua edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 169 më lart). Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, për qëllimet e nenit 6/1, një gjykatë nuk ka nevojë të jetë një gjykatë e integruar brenda mekanizmit standard gjyqësor. Ajo mund të krijohet për të shqyrtuar një çështje specifike e cila mund të administrohet në mënyrë të përshtatshme jashtë sistemit të zakonshëm të gjykatës (shih Mutu dhe Pechstein, cituar më lart, paragrafi 139).

288 Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK ashtu dhe KPA ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj. [...]

317 Nga kjo rrjedh se si KPK-ja, ashtu edhe KPA-ja ishin të pavarura dhe të paanshme. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në këtë drejtim.

të legjislationit që rregullon hetimin dhe procesin administrativ dhe nuk ka asnjë referim apo mbështetje në dispozitat që rregullojnë procesin penal.

Për më tepër, argumenti i përdorur prej subjektit të rivlerësimit se ndalimi i vendosur nga Komisioni për të qëndruar 15 vite jashtë sistemit të drejtësisë, si sanksion, tejkalon disa herë dënimet plotësuëse penale, nuk konsideron faktin se ky ndalim është i përcaktuar si sanksion në një normë kushtetuese dhe ka qenë ligjvënësi ai që me vullnetin e tij të legjitimuar prej pushtetit që i jep vota e sovranit, ka përcaktuar qartazi këtë nivel penalteti për rastet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, si pasojë e dorëheqjes nga detyra. Në këtë kuptim, përcaktimi i natyrës së nivelit të ashpërsisë së këtij penalteti del jashtë diskrecionit e vlerësimit të organeve të rivlerësimit, të cilat janë të detyruara ligjërisht në këto raste të zbatojnë këtë normë kushtetuese (Neni G) në mënyrë të drejtpërdrejtë, në raste të dorëheqjes së subjekteve përgjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

18.3. Kolegji gjithashtu sjell në vëmendje edhe trajtimin që një çështje e tillë ka gjetur edhe në vendimin e GjEDNj-së në çështjen A. Xh. kundër Shqipërisë, tek e cila [paragrafi 245] arsyetohet se: *Gjykata vëren se shkarkimi i kërkuësës është një sanksion karakteristik i një veprë disiplinore dhe nuk mund të ngatërrohet me një dënim penal. Ndaj saj nuk u vendos asnjë gjobë pas shkarkimit të saj. Gjykata më tej vëren se ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar ndalim të përhershëm të aplikimit për pozicionet në sistemin e drejtësisë. [...] Ky ndalim nuk është parashikuar në Kodin Penal dhe nuk mund të konsiderohet si një sanksion me natyrë kriminale. Qëllimi i ndalimit për t'u ribërë pjesë e sistemit të drejtësisë nuk duket të jetë vendosja e një ndëshkimi për shkarkimin nga detyra, por më tepër ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Edhe pse, në vetvete, ky ndalim duket sikur është një pasojë mjaft e rëndë, shumë masa jopenale të një natyre parandaluese mund të kenë një ndikim thelbësor mbi personin në fjalë. Fakti i thjeshtë që ndalimi është i një natyre të përhershme, nuk mjafton ta konsiderojmë atë si një ndëshkim.*

18.4. Në këto kushte, Kolegji çmon se ku pretendim i subjektit të rivlerësimit është i paargumentuar dhe i pabazuar në ligj.

19. Lidhur me shkakun e ankimit se ndalimi i subjektit të rivlerësimit për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për 15 vite, vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit që duhet të ruhet midis masës së marrë dhe situatës ligjore që e ka diktuar atë, Kolegji konstaton se:

19.1. Në ankim, në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka pretenduar se ka mungesë proporcionaliteti midis situatës që e ka diktuar vendimmarrjen e Komisionit (dorëheqjes së tij nga funksioni i magjistratit) dhe sanksionit të dhënë për ndalimin për të qenë 15 vite pjesë e sistemit të drejtësisë, me pasojë në të drejtat themelore të ankuesit. Sipas subjektit, sanksioni i vendosur nga Komisioni në pikën 2 të dispozitivit të vendimit objekt shqyrtimi, nuk ka konsideruar tri elementet e testit të proporcionalitetit mes sanksionit dhe situatës juridike që ka të bëjmë me faktin se çdo masë e organeve duhet të jetë: (i) e përshtatshme dhe efikase; (ii) e nevojshme; dhe (iii) proporcionale.

19.2. Në analizë të këtij shkakun ankimi, Kolegji çmon se ky pretendim i ngritur nga subjekti i rivlerësimit do të ishte i arsyeshëm dhe i pranueshëm nëse do të ishim para një mase disiplinore të dhënë prej Komisionit pas përfundimit të procesit të rivlerësimit, mbi të cilën, subjekti, në analizë të situatës së tij faktike, do të mund të ngrinte pretendimin se vendimi nuk ka konsideruar parimin e proporcionalitetit. Referuar rastit objekt shqyrtimi, siç është përshkruar edhe më sipër, Kolegji konstaton se vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit ka konkluduar me ndërprerjen e këtij procesi, pasi ka administruar akte që tregojnë dhe dëshmojnë në mënyrë të qartë vullnetin e lirë të subjektit për të hequr dorë në mënyrë të përvokueshme nga statusi i magjistratit. Në këtë kuptim, në konkluzionet e Komisionit nuk ka pasur asnjë vendimmarrje, e cila nevojitej të gjykohej nga Komisioni në zbatim të parimit të proporcionalitetit, duke qenë se pasojë e parashikuar nga ligji në

këto raste vjen si konsekuencë e drejtpërdrejtë e situatës faktike që lidhet me dorëheqjen dhe nuk është pjesë e ndonjë argumenti apo vlerësimi diskrecional të organeve.

Në këtë rast, konstatohet se situata faktike paraqet një vullnet të shprehur qartë nga vetë subjekti për të hequr dorë në mënyrë të parevokueshme nga statusi i magjistratit dhe se masa e marrë, pra vendosja e sanksionit për të qëndruar 15 vite jashtë sistemit të drejtësisë, është një sanksion i vendosur si i tillë nga një normë kushtetuese, në këtë rast neni G, e cila ndalimin për 15 vite e ka të përcaktuar si një periudhë fikse dhe jo si një periudhë të vendosur mes marzheve, brenda të cilave do të luante rol gjykimi apo vlerësimi proporcional i organeve.

19.3. Në këto kushte, nisur nga situata faktike dhe ligjore e kësaj çështjeje, këtë shkak ankimi Kolegji e gjen të pabazuar në prova dhe në ligj.

20. Në analizë të shkakut të fundit të ankimit, në të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se sanksioni i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, për të qëndruar 15 vite jashtë sistemit të drejtësisë, vjen në kundërshtim me të drejtën për privatësi që ofron neni 8 i KEDNj-së, Kolegji analizon sa vijon.

20.1. Prej subjektit, në mbështetje të këtij shkak ankimi, pretendohet se sanksioni sipas pikës 2 të vendimit të Komisionit, sjell pasoja të rënda në jetën e tij private, duke afektuar në mënyrë direkte aktivitetin profesional të tij, që përbën vlerë të mbrojtur qartësisht nga neni 8 i KEDNj-së.

20.2. Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji në vijim edhe të sa arsyetuar më sipër, thekson se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi ka ardhur si pasojë e dorëheqjes së subjektit nga statusi i magjistratit, pra nga shprehja para organit kompetent, KLGj-së, e vullnetit të qartë dhe të parevokueshëm të subjektit për të mos ushtuar detyrën e gjyqtarit, veprim i cili është ndërmarrë prej vetë subjektit në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tij dhe nuk ka ardhur si pasojë e një procedimi të mirëfilltë disiplinor apo vullnetit të ndonjë organi administrativ. Subjekti ka zgjedhur me vullnetin e tij t'i japë fund karrierës në sistemin e drejtësisë, duke njohur parashikimet e ligjit për pasojat që vijnë në këto rrethana, prandaj pretendimi se penaliteti ka cenuar të drejtat e tij të mbrojtura nga neni 8 i KEDNj-së, është i paarsyeshëm dhe i padrejtë.

20.3. Për më tepër, Kolegji, për këtë shkak ankimi, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë dhe argumentojë faktin se mosushtrimi i funksionit të gjyqtarit (prej të cilit ai dha dorëheqjen) i cenon atij të drejtën për të punuar në fusha të tjera të profesionit, duke rrezikuar të kthehet në një viktimë, të cilit i shkelet e drejta për të punuar, për sa kohë që ka shumë fusha, përveç gjyqësorit, në të cilat mund të ushtrohet profesioni i juristit, titull të cilin subjekti vazhdon ta gëzojë.

21. Në përfundim, Kolegji, pasi analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe shqyrtoi të gjitha aktet e marra gjatë hetimit administrativ në Komision, konkludon sa më poshtë.

i. Subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë se procedurat e kryera nga Komisioni për procesin e tij të rivlerësimit janë kryer në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për informim, si dhe përcaktimet e nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nga aktet e administruara rezulton se Komisioni ka lajmëruar subjektin e rivlerësimit për fazën në të cilën ndodhej hetimi dhe për vendimmarrjet e tij lidhur me të (*siç është njoftimi për mbyllje të hetimeve vetëm për kriterin e pasurisë*). Gjithashtu, nga aktet e administruara rezulton se, bazuar në kërkesën e subjektit, me qëllim për t'i garantuar atij ushtrimin e plotë të së drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, Komisioni ka shtyrë 2 (dy) herë zhvillimin e seancës dëgjimore.

Kolegji, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për paanësi dhe pavarësi të trupit gjykues të Komisionit, konstaton se vendimmarrja për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit ankues nuk ka ardhur për shkak të informacionit apo provave të mbledhura nga hetimet e kryera prej Komisionit, por si konsekuencë e vendimit nr. 61, datë 16.02.2021, të KLGj-së, i cili ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të subjektit të rivlerësimit, mbështetur në kërkesën e

tij për t'u dorëhequr nga ushtrimi i funksionit dhe ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar prej subjektit.

- ii. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ndalimi i tij për të qenë për 15 vite pjesë e sistemit të drejtësisë vjen në kundërshtim me natyrën administrative të procesit të rivlerësimit, si dhe të trupës gjyquese që e ka shqyrtuar atë, Kolegji vlerëson se është një pretendim i pambështetur në ligj, duke qenë se caktimi i këtij ndalimi bazohet në parashikimet e një norme kushtetuese, siç është neni G i Aneksit të Kushtetutës që aplikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga organet e rivlerësimit në rastet e dorëheqjes së subjekteve nga detyra përgjatë këtij procesi.
 - iii. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ndalimi për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për 15 vite vjen në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit që duhet të ruhet midis masës së marrë dhe situatës ligjore që e ka diktuar atë, Kolegji vlerëson se është i pabazuar në prova e ligj. Neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës ka parashikuar periudhën 15-vjeçare të ndalimit për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, si një periudhë fikse në rastet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke mos u lënë diskrecion organeve të rivlerësimit të vlerësojnë këtë periudhë në varësi të rrethanave të çështjes e zbatimit të parimit të proporcionalitetit.
22. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji e gjen të drejtë vendimin e Komisionit dhe çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës pasi dorëheqja e tij nga detyra ka sjellë si efekt ligjor ndërprerjen e procesit të rivlerësimit e për pasojë humbjen e të drejtës për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Për këtë arsye, Kolegji e gjen të drejtë përcaktimin e pikës 2 të vendimit të Komisionit nr. 365, datë 14.04.2021.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 365, datë 14.04.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Gramoz Levanaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 06.07.2021

ANËTARE
Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR
Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTAR
Ardian HAJDARI

nënshkrimi

RELATORE
Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE
Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi